



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2304 prot.

Fushë-Arrëz, më 04.08.2025

VENDIM

Nr. 25, datë 30.07.2025

“PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT PREJ 3 KËSHILLTARËSH NGA KËSHILLI I
BASHKISË PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS ME KOMISIONIN E NGRITUR
NGA KRYETARI I BASHKISË PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTIT LIDHUR ME
UJIN E PIJSHËM NË FSHATIN PORAV, NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË .**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak; Kërkesën me nr. prot 2140 të datës 21.07.2025, të shtetasit Gjok Gjergj Faslia, banues në fshatin Porav, Njësia Administrative Fierzë; Propozimin gjatë mbledhjes të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë për ngritjen e një komisioni prej tre këshilltarësh, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e datës 30.07.2025 duke marrë në konsideratë nevojën për ndërhyrje dhe ndërmjetësim për zgjidhjen e konfliktit mes dy palëve të përfshira si dhe rëndësinë e garantimit të furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm për banorët e zonës, pas diskutimeve nga Këshilltarë të pranishëm:

VENDOSI:

1. Të miratohet ngritja e një komisioni nga Këshilli Bashkiak për bashkërendimin e punës me komisionin e ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për qëllimin e zgjidhjes së konfliktit për ujin e pijshëm në fshatin Porav, Njësia Administrative Fierzë.
2. Përbërja e Komisionit me Këshilltarë është si më poshtë:

Franc Doda (Kryetar)

Afrim Ndoj (anëtar)

Bardhok Qafa (anëtar)

3. Komisioni do të ketë këto detyra:
 - Të zhvillojë vizitë në fshatin Porav, Njësia Administrative Fierzë;
 - Të zhvillojë takime me palët e përfshira për gjetjen e një zgjidhjeje konsensuale;
 - Të hartojë një raport përfundimtar me konkluzione dhe rekomandime për Këshillin Bashkiak menjëherë mbas marrëveshjes.
4. Ngarkohet Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe Sekretari i Këshillit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim u zbardh me datë **04. 08. 2025** dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar. Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Bashkëlidhur Komisioni i ngritur më herët nga Kryetari i Bashkisë.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

